




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DPKPP

Nr. Prot. 03-03/3351/16
Prot. No. 03-03/3351/16
Data Datum 28.09.2016
Date 28.09.2016
PRISHTINE

Nr. i faq. 03
Broj stranica 03
Nr. pages 03

DATË/A:	28.09.2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP 03-03/2806/16
PËR/ZA/TO:	z. Salih KQIKU, Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Gjilanit
CC:	z. Lutfi HAZIRI, Kryetar i Komunës së Gjilanit
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me material botues "

I nderuari z. Kqiku ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Furnizim me material botues" me numër të prokurimit: Gi651-16-060-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Furnizim me material botues" me numër të prokurimit: Gi651-16-060-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 22.08.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokoll *AKK-03-03-2806/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Furnizim me material botues*" me numër të prokurimit: *Gi651-16-060-121*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit.

Komuna e Gjilanit si Autoritet kontraktues ka përgatitur njoftimin për kontratë i cili njoftim është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me datë 29.07.2016. Agjencia kundër korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar tërë dokumentacionin dhe pasi ka trajtuar të njëjtin ka konstatuar faktet si në vijim:

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, Autoriteti kontraktues ka kërkuar që të furnizohet me material botues për njësit shpenzuese të Komunës së Gjilanit. Agjencia, pasi ka analizuar kërkesën e njësisë kërkuuese dhe dosjen e këtij tenderi, konstaton se Autoriteti kontraktues, ndër të tjera ka kërkuar të furnizohet me receta shëndetësore dhe fletëza kompjuterike, veprim ky i cili bie ndesh me Qarkoren informative nr.2/2016 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe udhëzimin administrativ nr.01/2010 për recetat në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës.

Në lidhje me këtë çështje me datë 23.09.2016, Agjencia i është drejtuar me shkresë zyrtare Ministrisë së Shëndetësisë të cilën e ka njoftuar se Agjencia është në dijeni se Ministria e Shëndetësisë ka kontratë me një Operator ekonomik, për furnizim me *receta shëndetësore* dhe *fletëza kompjuterike* që t'i furnizojë të gjitha Spitalet publike, QKMF-të dhe Institucionet tjera shëndetësore private. Përmes, kësaj shkrese Agjencia gjithashtu ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë, dëshmi në lidhje me atë se a kanë qenë të njoftuara të gjitha Spitalet, QKMF-të dhe Institucionet tjera private, lidhur me atë se duhet të furnizohen me këta artikuj vetëm nga Operatori ekonomik me të cilin ka kontratë të nënshkruar Ministria e Shëndetësisë dhe se nuk kanë të drejtë të furnizohen nga Operatorët tjerë ekonomik.

Me datë 26.09.2016, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë e cila ka sqaruar se mbështetur në udhëzimet administrative 01/2010 dhe 02/2010, Ministria e Shëndetësisë konform legjislacionit aktual në fuqi që përcakton format e dokumenteve shëndetësore, duke përfillur rregullat dhe procedurat ka përzgjedhur operatorin ekonomik dhe ka lidhur kontratë 36 mujore kornizë për furnizim me dokumentet shëndetësore - recetat, me nr. reference: 206/15/036/111, me operatorin ekonomik e përcaktuar si në kontratë. Për informimin e institucioneve shëndetësore publike dhe private, Ministria e Shëndetësisë ka publikuar në faqen elektronike qarkoren 02/2016, për më tepër është udhëzuar udhëheqësi i Divizionit për Akreditim dhe Licencim të Institucioneve Shëndetësore si njësi vartëse e Departamentit për zhvillim strategjik shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, që përmes postës elektronike të njoftoj institucionet e licencuara shëndetësore private në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se Njësia Kërkuese pranë Komunës së Gjilanit, ka kërkuar të furnizohet me artikujt si më lartë, ani pse për këta artikuj ka pasur kontratë Ministria e Shëndetësisë. Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues ka shkelur pikat prej 1 deri në 8 të Qarkores informative nr.2/2016.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, nenin 8 Planifikimi i Prokurimit dhe nenin 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Autoriteti kontraktues më konkretisht, Njësia Kërkuese duhet të ketë kujdes dhe të kërkojë vetëm ata artikuj për të cilët ekzistojnë nevoja reale dhe duhet që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se për artikujt e kërkuar nuk ka kontratë të nënshkruar.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

QAKES * QAKESQ.
KONT